



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 03 Dhjetor 2021

Nr: 469

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KRYQËZIMIT
TË TË DHENAVE ELEKTRONIKE DHE BIOMETRIKE TË MBLEDHURA NGA PAJISJET E
IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË
DATËS 25.04.2021**

Në mbështetje të neneve 14, 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, e 2, 23, pika 8, dhe 167/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhenave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik sipas dosjes elektronike të enkriptuar, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të bëhet kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara sipas listës në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI



Data: 03 Dhjetor 2021

Nr. 469

Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhenave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021



RAPORT

MBI GJETJET KYÇE TË PROCESIT TË KËQYRJES TË DHENAVE ELEKTRONIKE DHE BIOMETRIKE TË MBLEDHURA NGA PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25.04.2021.

HYRJE

Bazuar në: nenet 14, 19, pikat 1, shkronjat “c” e “n”, dhe 2, 23, pika 8, dhe 167/2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve janë kompetentë për mbikëqyrjen e procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik të cilat u aplikuan gjatë zgjedhjeve të vitit 2021. Procesi i verifikimit paszgjedhor të kryqëzimit të të dhënave ka për qëllim të përcaktojë efektshmërinë e teknologjisë së përdorur dhe rrjedhimisht të ndihmojë KQZ-në në vendimmarrjen e saj për përdorimin në vijim të teknologjisë..

Pas perfundimit te ketij procesi stafi i KQZ vijoi më pas me përpunimin dhe analizimin e të dhënave për përgatitjen e këtij raporti përmbledhës mbi tipologjite dhe llojet e shkeljeve te konstatuara.

I. MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE KRYQEZIMI

Pershkrim i sistemit te implementuar

Sistemi Elektronik Identifikimit te Votuesve përbëhet nga 3 komponentë:

- PEI, Pajisja Elektronike e Identifikimit; nje pajisje e integruar, portabël dhe e specializuar për zgjedhje, e cila përmban listen elektronike te zgjedhësve me te gjithë komponentët e nevojshëm për te bere te mundur një proces identifikimi te sigurt.
- VIUClient; programi i specializuar për identifikimin e zgjedhësve i instaluar ne Pajisjen Elektronike te Identifikimit.



- SEIV, Sistemi Elektronik i Identifikimit te Votuesve (server), i cili përbehet nga 2 komponentë:
 - CVIS Sistemi Qendror i Identifikimit te Votuesve, i cili bën te mundur përgatitjen dhe konfigurimin e PEI.
 - ABIS Sistemi i Automatizuar i Identifikimit Biometrik, i cili menaxhon procesimin e te dhënave biometrike, deduplikimin dhe detektimin e rasteve te dyshuara si votim i dyfishte/shumëfishtë.

Pas zgjedhjeve cdo Pajisje Identifikimi u kthye ne magazinat qendrore te KQZ per procesim. Memoriet USB u terhoqen nga pajisjet e identifikimit dhe u qenderzuan ne serverin SEIV duke populluar databazen CVIS ne nivelet hierarkike sipas shperndarjes gjeografike.

Pas procesit te konsolidimit te te dhenave, ABIS filloi procesimin e te dhenave duke kryqezuar cdo identitet kundrejt 1,602,741 votuesve te identifikuar gjate dites se zgjedhjeve te date 25 Prill 2021.

Pas procesimit ABIS prodhoi rastet e cilesuara nga sistemi si te dyshimta nga te cilat 1006 u konfirmuan nga stafi i trajnuar i KQZ prej kompanise kontraktuese si te genesishme.

II. KONSTATIME DHE PROBLEMATIKA

Në këtë kre janë analizuar dhe janë raportuar në mënyrë sintetike problematikat apo treguesit domethënës me gjetjet kyçe të këtij procesi.

1) GJETJET E PROCESIT TE KRYQEZIMIT TE TE DHENAVE

Bazuar në rezultatet e kryqezimit të të gjitha shenjave të gishtrinjëve të depozituara në të gjitha PEI te cilat kane qene funksionale dhe jane perdorur per identifikimin e zgjedhesve gjate dites se votimit, jane verejtur 3 tipologji rastesh te dyshimta.

a) Identitet i njejte ne QV te ndryshme

Zgjedhes te identifikuar nga 2 here secili, ne QV te ndryshme. Dokument identifikimi i skanuar ne 2 QV te ndryshme

Bazuar në rezultatet e kryqezimit të të gjithë identiteve te konsoliduara ne server, jane identifikuar 40 raste te dyshimta. Qe do te thote se 20 zgjedhes jane IDENTIFIKUAR nga 2 here secili ne QV te ndryshme qe perbejne 40 rastet e dyshimta. Pra i njëjti dokument ose numër personal është skanuar nga Pajisjet Elektronike te Identifikimit ne orare te ndryshme ne QV te ndryshme.

Zgjedhësit e përfshirë në këto raste janë identifikuar në QV në të cilën kanë emrin në listën e zgjedhjeve, ndërsa në QV të 2-të janë identifikuar si Administratë Zgjedhore ose si me Vendim Gjykatë.

b) Shenja gishti të skanuara 2 here

Shenja gishti unike të cilat janë skanuar 2 here. Pra 1 shenje gishti e lidhur me 2 nr personale të ndryshem.

Bazuar në rezultatet e kryqezimit të të gjitha shenjave të gishterinjve të konsoliduara në server, janë identifikuar 448 raste të dyshimta. Që do të thote se 224 shenja gishtash janë depozituar nga 2 here secili për Identitete të ndryshme që përbejnë 448 total raste të dyshimta. Pra e njëjta shenje gishti është skanuar nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit në orare të ndryshme për 2 persona të ndryshem, dmth 1 shenje gishti lidhet me 2 persona .

c) Shenja gishti të skanuara me shume se 2 here

Shenja gishti unike të cilat janë skanuar shume here. Pra 1 shenje gishti e lidhur me disa nr personale

Bazuar në rezultatet e kryqezimit të të gjitha shenjave të gishterinjve të konsoliduara në server, janë identifikuar 518 raste të dyshimta. Që do të thote se 44 shenja gishtash janë depozituar me shume se 2 here secili për Identitete të ndryshme që përbejnë 518 total raste të dyshimta. Pra e njëjta shenje gishti është skanuar nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit në orare të ndryshme për me shume se 2 persona të ndryshem, dmth 1 shenje gishti lidhet me shume persona.

2) HAPJA DHE MBYLLJA E PROCESIT TE IDENTIFIKIMIT


Pas përpunimit të të dhënave në lidhje me procesin e hapjes dhe të mbylljes së identifikimit u vërejtën gjetjet e mëposhtme.

a) Aktivizimi i Procesit të Identifikimit

Nga të dhënat e regjistruara nga Pajisjet Elektronike të Identifikimit na rezultojnë fashat e mëposhtme me oraret e hapjes së Pajisjes ose thënë ndryshe aktivizimi i procesit të Identifikimit Elektronik.

- PEI te aktivizuara **deri ne 7:00**; **2122 QV** ose **40.8%** e QV e kane kryer procesin e aktivizimit te pajisjes brenda ores 7:00
- PEI te aktivizuara ne **fashen orare 7:00 - 7:30**; **2365 QV** ose **45.5%** e QV e kane kryer procesin e aktivizimit te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te aktivizuara ne **fashen orare 7:31 - 8:00**; **360 QV** ose **6.9%** e QV e kane kryer procesin e aktivizimit te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te aktivizuara ne fashen orare **8:01 - 9:00**; **120 QV** ose **2.3%** e QV e kane kryer procesin e aktivizimit te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te aktivizuara ne fashen orare **9:01 - 10:00**; **25 QV** ose **0.5%** e QV e kane kryer procesin e aktivizimit te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te aktivizuara ne fashen orare **10:01 - 13:17**; **14 QV** ose **0.3%** e QV e kane kryer procesin e aktivizimit te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te pa-aktivizuara ose per te cilat **nuk ka informacion** jane **193 QV** ose **3.7%** e QV per te gjitha KZAZ.

Tabela 1 me shperndarjen e fashave orare me aktiviziminn e procesit zgjedhor.




Duke patur parasysh faktin qe procesi i identifikimit elektronik u fut per here te pare si pjese e procesit zgjedhor ne Shqiperi, jane te kuptueshme dhe vonesat ne fashat e mesiperme per aktivizimin e procesit. Gjithsesi vlen per tu nenvizuar se kompleksivisht 86.3% e QV arriten te hapnin procesin e identifikimit elektronik brenda ore 7:30. Per pjesen qe mbetet ka ndikuar ne vonesa shume faktore nga me te rendesishmit fakti qe qendra telefonike e suportit ne fashen orare te hapjes se QV arriti pikun e trafikut telefonik dhe nuk mund te merrte me thirrje. Vetem kur trafiku ra atehere keto QV arriten te merrnin instruksionet ose suportin e nevojshem per te kryer procesin e aktivizimit.

b) Mbyllja e Procesit te Identifikimit

Nga te dhenat e rregjistruara nga Pajisjet Elektronike te Identifikimit na rezultojne fashat e meposhtme me oraret e mbylljes se Pajisjes ose thene ndryshe mbyllja e procesit te Identifikimit Elektronik pra te procesit zgjedhor.

- PEI te mbyllura **ne fashen orare 18:00 – 18:44; 21 QV ose 0.4% e QV** e kane kryer procesin e mbylljes te pajisjes ose te procesit te votimit kete fashe orare.
- PEI te mbyllura ne **fashen orare 18:45 - 18:59; 246 QV ose 4.7% e QV** e kane kryer procesin e mbylljes te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te mbyllura ne **fashen orare 19:00 - 19:59; 4705 QV ose 90.5% e QV** e kane kryer procesin e mbylljes te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te mbyllura ne fashen orare **20:00 - 21:18; 16 QV ose 0.2% e QV** e kane kryer procesin e mbylljes te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te mbyllura **gjate orarit te procesit zgjedhor; 11 QV ose 0.2% e QV** e kane kryer procesin e mbylljes te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te mbyllura pas kthimit ne magazinat qendrore te KQZ; **7 QV ose 0.1% e QV** e kane kryer procesin e mbylljes te pajisjes ne kete fashe orare.
- PEI te pa aktivizuara ose per te cilat **nuk ka informacion** jane **193 QV ose 3.7% e QV** per te gjitha KZAZ.

Tabela 1 me shperndarjen e fashave orare me aktiviziminn e procesit zgjedhor.



Sic duket qarte dhe nga tabela ilustruese pjesa dermuese e Pajisjeve te Identifikimit rreth e kane mbyllur procesin e identifikimit ose thene ndryshe procesin e votimit pas ores 19:00 sic e parashikon dhe ligji. Nderkohe 11 QV te cilat e kane mbyllur gjate periudhes se procesit zgjedhor eshte bere per shkaqe teknike ose gabime nga ana e operatoreve.

III. REKOMANDIME

Në përfundim të procesit të kryqezimit dhe analizimit të të dhënave si dhe të problematikave të shfaqura gjatë periudhës zgjedhore dhe sidomos gjatë ditës së zgjedhjeve duke marrë në konsideratë problematikën e evidentuarë dhe të përcjellë edhe në këtë raport por jo vetëm, rekomandohet marrja e masave organizative të cilat synojnë rritjen e efikasitetit dhe vendimmarrjes së administratës zgjedhore. Njëkohësisht për shkeljet e konstatuara rekomandohet vijimi i

procedurave të mëtejshme administrative për vendosjen e sanksioneve administrative apo kallëzimin e tyre pranë organeve ligjzbatuese për shkeljet e konstatuara.

Rekomandime:

- Dakordësimi me DPGJC për afatin e dorëzimit, i cili të jetë jo më vonë se 1 javë pas afatit 45 ditor përpara datës së zgjedhjeve që parashikon ligji.
- Rekrutimi i stafit të përhershëm dhe përkohshëm specifikisht për Identifikimin Elektronik për të shmangur situata si rekrutimi, perzgjedhja, kontaktimi, mbikëqyrja, trajnimi, pagesa, etj.
- Koha e rekrutimit të bëhet me minimalisht 3 muaj përpara ditës së votimit. Gjatë thirrjes për aplikim të analizohen ato zona ku nuk ka aplikime dhe të shtyhet aplikimi nëpërmjet fushatave në rrjetet sociale të targetuar për zonat specifike ku ka mungesa, si dhe të shpërndahet aplikimi në të gjitha universitetet e vendit
- Transmetimi i të dhënave për pjesëmarrjen në zgjedhje në kohe reale ose me interval kohorë nga PEI për të qenë transparent në lidhje me pjesëmarrjen në votime
- Manualët dhe materialet trajnuese si dhe procedurat dhe dokumentacioni i cili përdoret nga KQV dhe ZAZ duhet të thjeshtohen
- Implementimi i sistemeve teknologjike ERP dhe Contact Center për të facilituar statusin dhe vendndodhjen e aseteve (PEI) për ERP dhe ngritja e një qendre shërbimi telefonik për të ofruar suport ndaj të gjithë aktoreve të përfshira me Identifikimin Elektronik.
- Rishikim i softëare (user experience) dhe nivelit të aksesit (konfigurues, operator, autorizues) të Pajisjes së Identifikimit për të thjeshtuar përdorimin dhe shmangur rastet mos vënies në punë.
- Unifikimi i formatit të përdorimit të QV sipas standartit që vjen nga DPGJC

Referim pranë organeve ligjzbatuese:

Në lidhje me rastet e evidentuara nga procesi i kryeqzimit të të dhënave biometrike sugjerohet referimi drejt prokurorisë për rastet:

- a) Identiteti i njëjtit në QV të ndryshme kur një zgjedhës është **identifikuar** nga 2 here secili, në QV të ndryshme. Dokument identifikimi i skanuar në 2 QV të ndryshme, për të verifikuar nëpërmjet pamjeve filmike nëse zgjedhësit e kanë kryer votimin ose jo në 2 QV të ndryshme.



- b) Shenja gishti te skanuara 2 here. Shenja gishti unike te cilat jane skanuar 2 here. Pra 1 shenje gishti e lidhur me 2 nr personale te ndryshem. Per tu verifikuar nepermjet pamjeve filmike nese ka qene tentative e operatoreve per te pershpejtuar procesin e identifikimit ose nese ka patur votim familjar ose per persona te tjere.
- c) Shenja gishti te skanuara me shume se 2 here. Shenja gishti unike te cilat jane skanuar shume here. Pra 1 shenje gishti e lidhur me disa nr personale. Per tu verifikuar nepermjet pamjeve filmike nese ka qene tentative e operatoreve per te pershpejtuar procesin e identifikimit ose nese ka patur votim familjar ose per persona te tjere.

Në përfundim të procesit të këqyrjes duke marrë në konsideratë gjetjet minimale te rasteve te dyshuara nga procesi i kryqezimit, sugjerojmë implementimin e sistemit te Identifikimit Elektronik në një shkallë më të gjerë në proceset e ardhshme të votimit.

Lidhja 1

Rasti Dyshuar	Nr. rasteve	Inici alet	Lloji I identifikimit	Nr. QV	ZA Z	Qarku	Bashkia	Njesia Administrative
2148088	2	A.A.	Vendim Gjykate	3724/1	73	Korce	Bashkia Korçë	Qendër _ KORÇE
2148088	2	A.A.	Lista Zgjedhore	3724	73	Korce	Bashkia Korçë	Qendër _ KORÇE
2158639	2	A.K.	Vendim Gjykate	3654/1	74	Korce	Bashkia Korçë	Korçë
2158639	2	A.K.	Lista Zgjedhore	3654	74	Korce	Bashkia Korçë	Korçë
2383132	2	A.H.	Lista Zgjedhore	3061	61	Fier	Bashkia Roskovec	Strum
2383132	2	A.H.	Vendim Gjykate	3060	61	Fier	Bashkia Roskovec	Strum
2569063	2	A.H.	Administrata Zgjedhore	3347/1	63	Berat	Bashkia Ura Vajgurore	Kutalli
2569063	2	A.H.	Lista Zgjedhore	3347	63	Berat	Bashkia Ura Vajgurore	Kutalli
2596995	2	A.M	Lista Zgjedhore	4261/1	80	Gjirokaster	Bashkia Gjirokastrë	Lazarat
2596995	2	A.M	Administrata Zgjedhore	4261	80	Gjirokaster	Bashkia Gjirokastrë	Lazarat
2633645	2	A.B.	Lista Zgjedhore	4261	80	Gjirokaster	Bashkia Gjirokastrë	Lazarat
2633645	2	A.B.	Administrata Zgjedhore	4288	82	Gjirokaster	Bashkia Dropull	Dropull sip.
2688879	2	G.B.	Lista Zgjedhore	4707	92	Vlore	Bashkia Konispol	Konispol
2688879	2	G.B.	Administrata Zgjedhore	4706	92	Vlore	Bashkia Konispol	Konispol
2705878	2	A.Z.	Administrata Zgjedhore	3525	64	Berat	Bashkia Kuçovë	Kuçovë
2705878	2	A.Z.	Lista Zgjedhore	3525/3	64	Berat	Bashkia Kuçovë	Kuçovë
2983022	2	L.K.	Administrata Zgjedhore	0744/1	13	Lezhe	Bashkia Lezhë	Shënkoll
2983022	2	L.K.	Lista Zgjedhore	0744	13	Lezhe	Bashkia Lezhë	Shënkoll
2983082	2	V.D.	Administrata Zgjedhore	0744/1	13	Lezhe	Bashkia Lezhë	Shënkoll
2983082	2	V.D.	Lista Zgjedhore	0744	13	Lezhe	Bashkia Lezhë	Shënkoll
2983359	2	K.M	Administrata Zgjedhore	0744/1	13	Lezhe	Bashkia Lezhë	Shënkoll
2983359	2	K.M	Lista Zgjedhore	0744	13	Lezhe	Bashkia Lezhë	Shënkoll
3036790	2	F.Z.	Lista Zgjedhore	2395	47	Elbasan	Bashkia Elbasan	Bradashesh,Gracen
3036790	2	F.Z.	Administrata Zgjedhore	2395/1	47	Elbasan	Bashkia Elbasan	Bradashesh,Gracen
3090166	2	D.N.	Lista Zgjedhore	1176/1	19	Diber	Bashkia Dibër	Fushë Cidhen
3090166	2	D.N.	Administrata Zgjedhore	1176	19	Diber	Bashkia Dibër	Fushë Cidhen
3312312	2	E.S.	Lista Zgjedhore	1453/1	24	Durres	Bashkia Durrës	Durrës R3
3312312	2	E.S.	Administrata Zgjedhore	1463	22	Durres	Bashkia Durrës	Durrës R5
3505975	2	A.X.	Lista Zgjedhore	1306/1	20	Durres	Bashkia Krujë	Fushe Kruje
3505975	2	A.X.	Vendim Gjykate	1306	20	Durres	Bashkia Krujë	Fushe Kruje
3544882	2	E.K.	Administrata Zgjedhore	1389	25	Durres	Bashkia Shijak	Shijak
3544882	2	E.K.	Lista Zgjedhore	1389/1	25	Durres	Bashkia Shijak	Shijak
3545195	2	I.A.	Administrata Zgjedhore	1933/1	38	Tirane	Bashkia Tiranë	Nr. 8
3545195	2	I.A.	Lista Zgjedhore	1937	38	Tirane	Bashkia Tiranë	Nr. 8
3621980	2	K.Z.	Lista Zgjedhore	2028/1	41	Tirane	Bashkia Tiranë	Nr. 11
3621980	2	K.Z.	Vendim Gjykate	2013/1	41	Tirane	Bashkia Tiranë	Nr. 11
3641159	2	I.I.	Lista Zgjedhore	1956	39	Tirane	Bashkia Tiranë	Nr. 9
3641159	2	I.I.	Administrata Zgjedhore	1956/1	39	Tirane	Bashkia Tiranë	Nr. 9
3717940	2	S.B.	Administrata Zgjedhore	1369/1	21	Durres	Bashkia Durrës	Rashbull
3717940	2	S.B.	Lista Zgjedhore	1369	21	Durres	Bashkia Durrës	Rashbull